



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 281/3 Prot.

Tiranë, më 03 . 03 . 2025

V E N D I M

Nr. 45 , datë 03 . 03 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 31 Regj., datë 11.02.2025, të znj. R. S, kundër Bashkisë Mat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës”, “gjinisë” dhe “gjendjes arsimore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga znj. R. S, evidentohet problematika e lindur me subjektin për të cilin pretendon se e ka diskriminuar, Bashkinë Mat, për të cilën, ndër të tjera, shprehet se:

“Kam lindur në Burrel me datë 10.07.1969 dhe jam banuese në Bushkash. Kam mbaruar arsimin e mesëm parashkollor “17 Nëntori”, në Tiranë në vitin 1990. Aso kohe kjo shkollë njihej si baza e arsimit shqiptar. Jam kualifikuar në të tria nivelet, kategoritë. Kam filluar punë në datë 01.10.1990, si mësuese-edukatore kopshti. Kam punuar 32 vite si edukatore në fshatin Bushkash. Për arsye të emigracionit, Kopshti e Shkolla ku punonja u mbyllën. Më datë 3 Nëntor 2022 u transferova në Kopshtin nr. 3, në Burrel. Fatkeqësisht pas 33 viteve punë kam marrë një vërejtje në Maj 2024. Në Burrel punova dy vite e dy muaj, dhe një ditë papritur më vjen një urdhër për transferimin tim nga Kopshti ku isha e punësuar në një çerdhe në qytetin e Ulzës. Unë këtë vendim nuk e pranova dhe nuk e firmosa, dhe për këtë arsye më ndërprejnë

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

marrëdhënien e punës, me datë 23.12.2024. Jam ankuar tek institucionet përkatëse por pa gjetur zgjidhje.

Unë nuk jam e fushës së çerdhes, dhe për këtë arsye e kam refuzuar transferimin tim, si edukatore në Kopshtin ku isha e punësuar, në edukatore në Çerdhe në Ulëz.

Kopshtet deri në 30 Nëntor 2015 varehin nga Drejtoritë Arsimore dhe me datë 30.11.2015 kaluan në varësi të bashkive.”

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, të rikthehet në vendin e punës që mbante si Edukatore Kopshti, para transferimit të saj në pozicionin e Edukatores së Çerdhes, sipas Urdhrit nr. 1203, datë 17.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë Mat.

- Pas regjistrimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, lidhur me provueshmërinë e disa prej deklarimeve të bëra prej saj me shkaqet e pretenduara, kundrejt punëdhënësit, Bashkisë Mat.
- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mailit datë 11.02.2025, nga ana e inspektorit të çështjes është proceduar me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit e informacionit të nevojshëm për vijimin e shqyrtimit të ankesës së saj, duke i lënë dhe një afat të arsyeshëm kohor.
- Në vijim të sa më sipër, nëpërmjet shkresës me datë 14.02.2025, ankuesja ka dërguar shpjegimet e saj, të cilat në thelb janë të njëjta me parashtrimet e depozituara në ankesën me nr. 31 Regj., datë 11.02.2025.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga këqyrja e analizimi i parashtrimeve dhe dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:

Subjekti ankues ka nisur marrëdhënien e punës me Drejtorinë Arsimore Mat, më datë 01.10.1990, në pozicionin e Edukatores së Kopshtit. Më datë 01.12.2015, ankuesja marrëdhënien e punës e vijon me punëdhënësin Bashkinë Mat (*marrëdhënie e cila erdhi erdhi si rezultat i kalimit të kopshteve në varësi të njërive të vetëqeverisjes vendore, bashkive*).

Për rreth 32 vite, znj. S ka punuar si edukatore në fshatin Bushkash. Nga 1990 deri në 2015 ka punuar në Kopshtin Bushkash, (*me punëdhënësin Drejtorinë Arsimore Mat*) ndërsa në 2015 ka kaluar si mësuese e ciklit parashkollor në shkollën 9-vjeçare Bushkash (*me punëdhënësin Bashkinë Mat*).

Nga data 01.11.2022, për shkak të rënies së numrit të nxënësve në këtë Shkollë, si pasojë e emigrimit të popullsisë së kësaj zone, znj. S është transferuar në Kopshtin nr. 3, Burrel, në detyrën e edukatores.

Me Urdhrin nr. 1203, datë 17.12.2024 “Për emërim në detyrë të znj. R. S”, të Kryetarit të Bashkisë Mat, ankuesja është emëruar në pozicionin Edukatore çerdheje, në Qendrën Sociale Multifunktionale, në Drejtorinë e Shërbimeve Komunitare, në Agjencinë e Funksioneve të Patransferueshme, Bashkia Mat.

Ankuesja ka refuzuar të paraqitet në vendin e ri të punës, pasi nuk ka rënë dakord me këtë emërim, duke parashtruar para strukturave respektive të punëdhënësit se arsyeja e refuzimit të saj lidhet me faktin se ka mbaruar arsim të mesëm parashkollor dhe ka punuar prej rreth 35 vitesh si edukatore dhe nuk e njeh fare çerdhen, prandaj ky transferim i duket i padrejtë.

Me shkresën me nr. 198 prot., datë 15.01.2025, ankuesja është njoftuar nga ana e Bashkisë për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.

Referuar procesverbalit të datës 20.01.2025, rezulton që ankuesja është paraqitur në takimin e njoftuar për fillimin e ecuresë disiplinore kundrejt saj, dhe është shprehur se nuk ka vajtur në vendin e ri të punës dhe refuzon ta pranojë këtë emërim, pasi i duket i padrejtë, duke qenë se ajo ka punuar ndër vite si edukatore kopshti dhe nuk e njeh punën si edukatore çerdheje.

Pas këtij takimi, me Urdhrin nr. 57, datë 22.01.2024 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me znj. R. S”, të Kryetarit të Bashkisë Mat, është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënies së punës të znj. R. S, me detyrë Edukatore çerdheje, në Qendrën Sociale Multifunktionale, në Drejtorinë e Shërbimeve Komunitare, në Agjencinë e Funksioneve të Patransferueshme, me motivacionin: “Mosparaqitje në punë pa shkaqe të arsyeshme”.

Lidhur me argumentimin e Bashkisë Mat se largimi i ankuses kishte ardhur për shkak të mosparaqitjes në pozicionin e saj të punës, Komisioneri vlerëson se:

Momenti i transferimit të ankuses nga “Edukatore” në Kopshtin Nr.3, Burrel, në “Edukatore çerdheje” në Qendrën Sociale Multifunktionale, në Drejtorinë e Shërbimeve Komunitare, në Agjencinë e Funksioneve të Patransferueshme, Bashkia Mat, është në fakt ndërprerje e kontratës të punës, pasi kanë ndryshuar elementët e saj.

Me anën e Urdhrit nr. 57, datë 22.01.2024 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me znj. R. S”, është krijuar një marrëdhënie e re pune mes të dy palëve, e cila do të duhej të rregullohej përmes një kontrate të re pune, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 23, të Kodit të punës:

“21. Kontrata e punës mund të lidhet dhe të ndryshohet me gojë se me shkrim. Ajo mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje midis palëve. Çdo ndryshim i kontratës së shkruar në dëm të punëmarrësit, duhet të përfundohet me shkrim”.

“23. Punëmarrësi nuk është i detyruar të zbatojë urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit, që ndryshojnë kushtet e kontratës së punës. Ndryshimi i kontratës bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve”.

Në kontekst të sa mësipër, Komisioneri do të analizojë pretendimet e ankuses lidhur me momentin e transferimit të saj dhe veprimet e punëdhënësit lidhur me emërimin e znj. S si edukatore çerdheje, pasi në vetvehte transferimi i saj është zgjidhje e njëanshme e kontratës së saj të punës.

Transferimi i saj ka sjellë si pasojë edhe ndryshimin e kushteve të kontratës të punës në dëm të saj, në mënyrë të njëanëshme, çka në fakt është dhe zgjidhje e saj.

Ndër të tjera, ankueses i është ndryshuar *pozicioni* (detyrat funksionale) dhe *vendi i punës*, gjë që ankuesja e kishte refuzuar.

Komisioneri vlerëson se, megjithëse ankuesja e ka kundërshtuar transferimin e saj dhe ia ka bërë të ditur shkresërisht punëdhënësit këtë fakt, Bashkia ka zgjidhur marrëdhënien e punës me të, duke marrë të mirëqenë emërimin e saj në pozicionin e edukatores së çerdhes.

Ligji nuk mund të parashikojë çdo detaj të një marrëdhënieje pune, prandaj ai i jep mundësinë palëve që të ndërtojnë një kontratë pune, duke u treguar se cilët janë elementet e detyrueshëm që duhet të vendosin në të dhe cilat janë kufijtë, të cilat palët nuk mund të kalojnë sa i takon aspekteve minimale të mbrojtjes në punë, ndër të cilat, edhe përsa i takon kushteve të punës. Pra, sikurse shihet, çdo ndryshim i kushteve të kontratës, pa miratimin e punëmarrësit do të konsiderohet zgjidhje e kontratës në mënyrë të njëanshme.

Në këtë kontekst, transferimi i znj. S përbën ndryshim të kontratës së punës në dëm të saj si punëmarrëse, dhe nuk është i vlefshëm për sa kohë ajo nuk ka rënë dakord me të. Përkundrazi, rezulton e provuar dhe dokumentuar se ankuesja e ka kundërshtuar atë. *(Fakt ky i dokumentuar në procesverbalin e mbajtur me datë 20.01.2025).*

Sa i takon pretendimit të palës ankuese, se është diskriminuar nga ana e Bashkisë Mat, duke i zgjidhur marrëdhënien e punës (fakt ky i lidhur me momentin e transferimit të saj nga edukatore kopshti në edukatore çerdheje²), për shkaqet e pretenduara, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

² Për analogji citojmë vendimin nr. 221, datë 20.12.2022, të KMD-së.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Pas analizimit sa më sipër, si dhe akteve të depozituara nga subjekti ankues, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e LMD-së, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, lidhur me identifikimin e provueshmërinë e shkaqeve “moshë” dhe “gjini”, bazuar në të cilat ankuesja pretendon se është diskriminuar nga Bashkia Mat.

Komisioneri vëren se, ankuesja kur citon shkaqet e “gjinisë”, dhe “moshës”, për të cilat pretendon diskriminimin nga ana e Bashkisë, evidenton faktin se këto shkaqe ajo i lidh me *pasojat* që i vijnë nga zgjidhja e marrëdhënieve të punës, në kontekst të vështirësisë që mund të hasi për t’u punësuar rishtaz, për shkak të moshës (*evidentojmë që ankuesja është e moshës 55 vjeç*) dhe qenies së saj grua, dhe jo me faktin që veprimet e punëdhënësit/Bashkisë kanë ardhur pikërisht për shkak se ajo posedon këto cilësi apo shkaqe apo të jetë motivuar prej tyre.

Kur ankueses i është kërkuar nga ana e KMD-së, nëse ajo është vënë në kushte të padrejta, të pabarabarta e të pafavorshme, krahasuar me punonjës të tjerë (*të cilët kanë moshë dhe gjini të ndryshme nga ajo*), ajo është shprehur se këtë fakt e lidh me mbrojtjen ligjore që duhet të kishte ajo për shkak të vështirëve që hasin gratë në moshën e saj për t’u punësuar rishtaz. Ankuesja nuk ka parashtruar apo sqaruar rrethana me fakte e prova se si ajo është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e Bashkisë, apo se si ky trajtim lidhet me këto shkaqe të pretenduara prej saj.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet sipërcituar, Komisioneri vëren se, *parimisht*, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrtojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi janë mosha e gjinia e ankueses.

Pala ankuese nuk parashtron fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime të Bashkisë që të jenë motivuar nga këto shkaqe.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Së dyti, subjekti ankues, në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, evidenton faktin se, zgjidhja e marrëdhënieve të punës nga ana e Bashkisë³, ka ardhur për shkak të gjendjes arsimore të saj, duke shpjeguar se *plotëson kriterin e arsimit dhe kualifikimit të kërkuar për pozicionin e punës edukatore kopshti dhe nuk ka punuar asnjëherë në çerdhe dhe nuk e njeh punën në çerdhe*.

Në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimet respektive të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të dala në zbatim të këtij Ligji, përcaktohet se, mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor.

Profesioni i mësuesit mund të ushtrohet edhe nga persona që zotërojnë diplomat e njëvlershme, diplomat e ngjashme ose të përafërta me diplomën e sipërpërmendur, sipas udhëzimit të Ministrit, siç është rasti i ankueses e cila ka përfunduar studimet në shkollën e mesme pedagogjike.

Bazuar në të dhënat e dokumentacionit dërguar nga ankuesja, evidentohet se znj. S ka përfunduar arsimin e mesëm pedagogjik, si dhe ka një eksperiencë rreth 35 vjeçare në pozicionin e mësuesit për arsimin parashkollor (edukatore kopshti).

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëlllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”⁴

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte

³ Transferimi i saj nga edukatore kopshti në Burrel në edukatore çerdheje në Mat.

⁴ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkaku të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesja ka ngritur pretendime për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën pranë KMD-së, Bashkisë Mat, duke pretenduar se është gjendur në një situatë diskriminuese, situatë e cila supozohet se ka si shkak gjendjen arsimore me shpjegimin se: *“Ka refuzuar të punojë edukatore në çerdhe, pasi ka punuar për rreth 35 vite si edukatore kopshti dhe nuk e njej punën si edukatore çerdheje.”*

Në kuptim të LMD-së, **“Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.”**⁵

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në mënyrë të shprehur në lidhje me shkaku e gjendjes arsimore, të pretenduar nga ankuesja si arsyeja ose shkaku për të cilën ajo i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe të disfavorshëm, duke u transferuar nga edukatore kopshti në edukatore çerdheje.

⁵ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

LMD nuk jep një përkufizim se çfarë duhet të kuptohet me shkakun e gjendjes arsimore. Në praktikën e tij Komisioneri ka vlerësuar se⁶, *gjendja arsimore si shkak diskriminimi*, nënkupton nivelin individual të arsimit, arrijtjet në arsim, aftësitë, certifikatat dhe mundësitë në lidhje me arsimin të cilat një person posedon⁷.

Duke iu rikthyer fakteve, rrethanave dhe pretendimeve për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore të paraqitur nga ankuesja Komisioneri Konstaton se:

Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri arrin në përfundimin se, pavarësisht se, shkakun i gjendjes arsimore, i pretenduar nga ankuesja si shkak i mbrojtur apo shkak diskriminues, përbën një shkak të mbrojtur nga LMD, faktet dhe rrethanat e parashtruara nga ankuesja, nuk ngrenë pretendime për diferencë në trajtim që kanë në bazë gjendjen arsimore të ankuseses, duke iu referuar nivelit arsimor të saj (diplomës së shkollës së mesme pedagogjike)

Lidhur me sa më lart, si dhe me shpjegimet që jep ankuesja se ajo plotëson kriterin e arsimit të kërkuar si edukatore kopshti, Komisioneri, vlerëson se, përmbushja e tij është kërkesë e cila shkon në përputhje me kërkesat e këtij pozicioni pune dhe se, pasja apo posedimi i tij nuk përbën një “shkak të mbrojtur” sipas LMD-së, në kuptimin që t’i kenë dhënë ankuseses një “status” apo t’i kenë veshur asaj cilësi personale apo karakteristika të identifikueshme, të dallueshme individuale.

Përmbushja e këtyre kërkesave është kriter paraprak dhe detyrim për emërimin e një punonjësi në këtë detyrë. Komisioneri vlerëson se, kriteri arsimor i kërkuar për pozicionin edukatore kopshti/çerdhje është i njëjtë për pozicionin edukatore, mësuese parashkollore, pavarësisht faktit nëse punonjësi është i emëruar dhe ushtron detyrën në kopsht apo çerdhe.

Komisioneri vëren se, arsyetimi i përdorur nga punëdhënësi për transferimin e ankuseses, mund të lidhet me ligjshmërinë apo jo të veprimeve, apo vërtetësinë e argumenteve të dhëna prej punëdhënësit për emërimin e saj edukatore çerdheje, por nuk lidhen me cilësitë e karakteristikat e identifikueshme të ankuseses në kontekst të shkakut të mbrojtur sipas LMD-së.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuseses për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, sipas kuptimit të LMD-së, nuk rezulton i bazuar në provat e depozituara prej saj⁸.

⁶Diskriminimi për shkak të gjendjes arsimore mund të paraqitet si vendosje të kriterëve për nivelin e arsimit për të aplikuar për një vend të caktuar pune, dhe të cilat nuk janë të arsyeshme dhe të arsyetuara (për shembull, kërkimi i arsimit të lartë për vendin e punës sanitar); ose rasti kur një person ka mbaruar arsimin e lartë 4-vjeçar dhe nuk pranohet të aplikojë ose s’kualifikohet pasi shpallja parashikon arsimin 3+2; ose kur vendoset kriter punësimi arsimit i mbaruar në një universitet të caktuar, pa ndonjë arsye objektive, duke përjashtuar aplikantë që janë arsimuar në universitete tjera.

⁷ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

⁸ Për analogji citojmë vendimin, nr. 213, datë 25.10.2023, nr. 264, datë 28.12.2023, dhe nr. 258, datë 30.09.2024, të KMD-së.

Pala ankuese nuk parashtron e argumenton bindshëm me fakte e prova, se është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të diferencuar nga ana e punëdhënësit, lidhur me zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës, trajtim i cili të jetë motivuar pikërisht nga gjendja arsimore. Sa më sipër, gjendja arsimore e ankuses, nuk rezulton që të jetë arsyeja apo shkak i transferimit të saj (*emërimit edukatore çerdheje*).

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se:

“4. Ankesa nuk pranohet nëse:ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/ të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues R. S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Hartoi: R. Hoxha
Pranoi: V. Bushati
Datë: 21.02.2025